




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 61/19
62/19
65/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z.Goran Milenković– Kryetar, z.Nuhi Paçarizi- Referues, z.Blerim Dina- Anëtar, duke vendosur sipas ankesave të parashtruara nga operatorët ekonomik: “Toifor”-Prishtinë, për LOT 1,2,3,4,5 dhe 6, ankesën e OE “Ve-mor”-Pejë për LOT 6 dhe ankesën e OE “VZ Company”-Prishtinë për LOT 2, të parashtruara kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, deblllokomi i kanalizimit atmosferik” i ndarë në 6 lot-e me nr. prokurimi 616-18-440-2-1-1 -1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Komuna e Prishtinës, më datën 18.03.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: “Toifor” -Prishtinë, “Ve-mor”-Pejë, dhe OE “VZ Company”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, deblllokomi i kanalizimit atmosferik “ i ndarë në 6 lot-e me nr. prokurimi 616-18-440-2-1-1 -1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Komuna e Prishtinës.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës dhe Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull : “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, deblllokomi i kanalizimit atmosferik “ i ndarë në 6 lot-e me nr. prokurimi 616-18-440-2-1-1 -1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Komuna e Prishtinës, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim** për Lot 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatoreve ekonomik ankues “Toifor” -Prishtinë, OE “Ve-mor”-Pejë, dhe OE “VZ Company”- Prishtinë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, operatorëve ekonomik ankues i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Hapja e ofertave është bërë me dt:13.11.2018

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 27.08.2018

Data e përfundimit të vlerësimit të AK-së, është bërë me dt: 10.12.2018

Njoftimi i vendimit nga AK, është bërë me dt:12.12.2018.

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 30.01.2019.

Me dt: 04.02.2019, Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesat për rishqyrtim si të pa bazuar.

Operatorët ekonomik ankues: “Toifor”-Prishtinë, si palë tëpa kënaqurakanë deponuar ankesë në OSHP, me 12 Shkurt 2019, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, deblokimi i kanalizimit atmosferik “ i ndarë në 6 llote me nr. prokurimi 616-18-440-2-1-1 -1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Komuna e Prishtinës, duke pretenduar ne shkelje te këtyre dispozitave ligjore te LPP-se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 6, 7, 52, 59, 69, dhe 72, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatorët ekonomik ankues: “Ve-mor”-Pejë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 13

Shkurt 2019, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, deblokimi i kanalizimit atmosferik “ i ndarë në 6 llote me nr. prokurimi 616-18-440-2-1-1 -1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Komuna e Prishtinës, duke pretenduar ne shkelje te këtyre dispozitave ligjore te LPP-së:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me neni 1 paragrafi 1,2,3 neni 6paragrafi 1, neni 7paragrafi 1,2,4, neni 56, 59paragrafi 4, neni 60paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 neni 52paragrafi 3, dhe 72, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatorët ekonomik ankues:“VZ Company”- Prishtinë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 13 Shkurt 2019, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, deblokimi i kanalizimit atmosferik “ i ndarë në 6 llote me nr. prokurimi 616-18-440-2-1-1 -1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Komuna e Prishtinës, duke pretenduar ne shkelje te këtyre dispozitave ligjore te LPP-se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 6, 7, 52, 59, 69, dhe 72, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 20.02.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues në raportin e datës: 04.03.2019, ka sqaruar se ky aktivitet i prokurimit fillimisht është vlerësuar nga ana e komisionit vlerësues i formuar me datë: 14.11.2018, dhe për kontratë janë rekomanduar OE-të.

1. Lot 1 OE. “Ve-mor” me çmim prej 179,398.05€
2. Lot 2 OE. “Pastrimi” me çmim prej 126,975.14€
3. Lot 3 OE “ OEToifor “ me çmim prej 409,969.38€
4. Lot 4 OE. “Niti-N& Milenium Konstruktion” me çmim prej 194,391.65€
5. Lot 5 OE. “Zahiri” me çmim prej 213,680.72€
6. Lot 6 OE “ElBau” me çmim prej 283,927.96€

Në mesin e tyre të rekomanduar për kontratë kanë qenë edhe operatorët ekonomik ”Toifor” dhe “Ve-mor”,

ndërsa OE "VZ Company" nuk ka qenë i rekomanduar.

Autoriteti Kontraktues me datë: 10.12.2018, ka marre vendim për shpërblim me kontratë për të gjithë llotet , por pas parashtrimit të Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar nga OE "Dardania" për llotet 1, 2, 4 dhe 6 , Autoriteti Kontraktues, e pezullon të gjithë aktivitetin e prokurimit edhe pse në lot 3 dhe 5 nuk ka pas Kërkesë për Rishqyrtim nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës .

Pas parashtrimit të Kërkesës për Rishqyrtim AK, ka anulua vendimin për shpërblim për të gjitha llotet, por nuk ka dhënë arsyet e anulimi të lotove për të cilat nuk janë parashtruar Kërkesa për Rishqyrtim.

AK krijon komision të ri për rivlerësim, dhe pas rivlerësimit për kontratë propozon operatorët ekonomik si në vijim:

1. Lot 1 OE "Dardania" me çmim prej 261,722.50€
2. Lot 2 OE "Elbau" me çmim prej 245,418.44 €
3. Lot 3 - Anulohet
4. Lot 4 OE "Niti-N&MileniumKonstruction" me çmim 194,391.28€
5. Lot 5 OE "Zahiri" me çmim prej 213,680.72€
6. Lot 6 - Anulohet

Eksperti shqyrtues ka sqaruar pretendimet ankimore të OE-së, "Toifor"-Prishtinë.

OE "Toifor" -Prishtinë, fillimisht kualifikohet i përgjegjshëm dhe rekomandohet për kontratë për Llot 3, por pas Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar për llotet 1, 2, 4 dhe 4 Autoriteti Kontraktues pa ndonjë arsyetim e rivlerëson edhe llotin 3, dhe në bazë të rezultateve të rivlerësimit OE "Toifor" -Prishtinë, rezulton të jetë i papërgjegjshëm.

Pas Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar me datë: 30.01.2019, nga e OE "Toifor" Autoriteti Kontraktues, e refuzon kërkesën e tillë me arsyetimin se OE "Toifor", nuk plotëson kërkesat për makineri pasi që nuk ofron kamioneta mbi 3.5 tonë.

Duke i referuar pretendimeve ankimore, eksperti shqyrtues konstaton se sa i përket makinerisë (pajisjeve) AK nuk ka respektuar dispozitat e nenit 7 të LPP-së, pas që AK nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë OE ankues në raport me OE të rekomanduar. Pjesa më e madhe e OE të cilët janë rekomanduar për kontratë ju kanë pranuar pajisjet duke i pranuar si të pranueshme edhe përmes video incizimeve.

Eksperti Shqyrtues konstaton se qëndron arsyeja e AK se kamionetat nuk janë mbi 3.5 ton, por

kërkesa për numrin e kamionëve është plotësuar nga ana e OE "Toifor" -Prishtinë, për faktin se përllot 3 janë kërkuar 5 kamionë dhe për llotet tjera nga 4 kamion, ndërsa janë ofruar 7 kamion që do të thotë se kjo kërkesë është e plotësuar në përputhje me kërkesat e dosjes pavarësisht kamionetave të theksuara. Çdo makineri bartëse e cila është mbi 3.5 tonë me peshë bartës në esencë nënkupton se pajisjet e tilla (makineritë) kanë të bëjnë me kamion e jo me kamioneta.

Të gjithë OE të cilët janë përzgjedh për rekomandim për kontrata kanë ofruar pajisje të tilla madje edhe pajisje që janë deklaruar jo përmes dëshmive siç janë faturat kontratat apo DUD-të doganor, por janë vlerësuar përmes video incizimeve dhe nëse referohemi vlerësimin të tillë kjo ka të bëjë me mos respektim të nenit 7 të LPP-së.

Në pretendim ankimor është theksuar kur AK ka pranuar pajisje për operatorët tjerë që lidhen me kamionetat 3.5 tonë të cilat jo vetëm që nuk e kanë peshën e kërkuar por si të tilla nuk janë kamioneta por janë pajisje për shpërndarje të kripës siç është rasti për automjetet me regjistrim automjeti 01-599-1H dhe automjet me regjistrim 01-599-LK të OE "Niti-N& Milenium Konstruktion.

Autoriteti kontraktues në kuptim të nenit 52 dhe 59 të LPP-së, vlerësimin ofertave nuk e ka bërë në përputhje me nenin 52 dhe 59 të LPP-së pasi që si automjete të pranueshme lidhur me kërkesën "kamioneta 3.5 ton" ka pranuar automjete që kanë peshe bartëse mbi 15 mijë apo 20 mijë tonë siç është rasti me OE "Dardania" apo operatorët tjerë.

AK për të gjithë operatorët ekonomik të rekomanduar për kontratë përveç sqarimeve i ka vizituar edhe vende punishtet, por një gjë të tillë nuk e ka bërë edhe me OE "Toifor"-Prishtinë, dhe në të shumtën e rasteve ka konstatuar se pajisjet e deklarua nga Operatorët Ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk gjinden në vend punishte por janë vlerësuar në bazë të video incizimeve, ndërsa për OE "Toifor" nuk ka ndërmarr asnjë veprim për ndonjë sqarim edhe pse paraprakisht ka qenë i përgjegjshëm dhe është rekomanduar për kontratë për llot 3 pasi që është konsideruar i përgjegjshëm dhe ka ofruar çmim me të lirë.

Sipas kërkesave të dosjes AK në dosje e ka vendosur që OE edhe pse i plotësojnë kërkesat në më shumë lloje me kontratë nuk mund të shpërblehen me shumë se një lloje ankese i ankese i atakon të gjitha llotet por duke pasur parasysh kërkesat e dosjes Eksperti Shqyrtues rekomandon që llot3 të ri vlerësohet.

Eksperti shqyrtues ka sqaruar pretendimet ankimore të OE "Ve-mor"-Pejë.

OE ankues "VE-mor"-Pejë, është eliminuar në mungesë të plotësimit të kërkesave të nenit 91 dhe 9.2 të dosjes së tenderit konkretisht për shkak të mos posedimit të makinerisë.

Sipas Autoritetit Kontraktues arsyeja e pare e eliminimit është se OE"Ve-mor" –Pejë, paraprakisht ka lidh kontrate me Komunën e Prishtinës për mirëmbajtje dimërore të rrugëve rurale dhe njëkohësisht makineritë e tilla nuk mund të përdor edhe në rastin konkret, dhe arsye e dytë është se gjatë vizitës në vende punishte është vërtetuar se një numër i makinerish (cisternat) janë jashtë funksionit (përdorimit) dhe si të tilla nuk mund të merren për bazë në vlerësim.

Eksperti shqyrtues arsyen e parë për eliminim e konsideron jo të drejtën sepse AK nuk mund të marrë për bazë një justifikim të tillë për eliminim.

Nëse Komuna e Prishtinës, merr për bazë një arsye të tillë për eliminim atëherë pjesa më e madhe e OE të cilët kanë kontratë me Komunën duhet refuzuar që në fillim pasi secili prej tyre mund të ketë një kontratë paraprake, dhe të paktën një gjë e tillë edhe nëse aplikohet duhet potencuar në dosje të tenderit.

Arsyen e dytë të eliminimit Eksperti Shqyrtues e konsideron të qëndrueshme pasi që komisioni vlerësues sipas raporteve ka dalë në vizitë në teren dhe ka konstatuar se një numër i pajisjeve konkretisht cisternat të cilat janë prezantuar në ofertë ka konstatuar se janë jashtë funksionit, dhe nuk janë fare të regjistruara, pastaj komisioni gjatë vizitës nuk ka gjetur frezat dhe OE"Ve-mor" nuk ka arritur të dëshmojë se i posedon.

Në mënyrë indirekte në pretendimet ankimore edhe vet OE ankues e pranon se me rastin e vizitës se komisionit pajisjet nuk kanë qenë në funksion dhe frezat nuk kanë qenë në deponipasi që kanë qenë të dhanuna me qira, dhe në pretendime ankimore OE "Ve-mor" e ngrit një shqetësim lidhur me mos njoftimin e me hershem për një vizitë në vend punishte, por duhet theksuar se kjo është e drejtë e rezervuar e Autoritetit Kontraktues kur ka dyshime rreth posedimi të pajisjeve të bëjë vizita apo të kërkojë dëshmi shtesë.

Eksperti shqyrtues ka sqaruar pretendimet ankimore të OE"VZ Company"-Prishtinë.

Sipas vendimit të datës: 04.02.2018 të AK-së, lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 30.01.2019, të parashtruar nga OE."VZ Company" arsyet e eliminimit janë pasi OE ankues nuk plotëson kërkesat për makineri konkretit aneksin 7 të dosjes së tenderit.

Sipas këtij aneksi janë kërkuar pajisje të quajtura kamioneta 3.5 ton, dhe si të tilla OE ankues nuk i ka ofruar.

Eksperti shqyrtues ka analizuar listën e pajisjeve të OE."VZ Company" dhe me këtë rast konstaton se pajisjet me nr regjistrimi 04-688 KR dhe 01-163-GN janë pajisje që nuk e arrijnë peshën 3.5 ton. Në këtë kontest Eksperti Shqyrtues, vlerëson se kërkesa përkëto lloj makinerish ka qenë jo e qartë për Operatorët Ekonomik është dashur të reagojnë gjatë fazës së tenderit pasi që në Aneks të dosjes shprehimisht thuhet "kamionetë 3.5 ton, për bartje të mbeturinave, minimum"

Eksperti ka analizuar listën e pajisjeve të parashtruar nga OE "VZ Company" dhe sipas ofertës nuk ka

dorëzuar numër me të madh të pajisjeve se sa numri i pajisjeve të kërkuara në mënyrë që të merren për bazë për vlerësim apo numri i tyre të verifikohet.

Sipas pretendimeve ankimore për kërkesën për kamioneta 3.5 ton, janë ngritur disa çështje që kanë të bëjnë me kategorizimin e automjeteve, mirëpo kjo çështje si e tillë paraprakisht është dashur të ngritet tek Autoriteti Kontraktues dhe të kërkoj sqarime se për çfarë automjete behet fjalë.

Eksperti Shqyrtues pajtohet se nëse behet fjale për automjete për bartje me peshë më të madhe se 3.5 ton nuk kemi të bëjmë me të ashtuquajture kamioneta por sipas emërimit dhe kategorizimit të automjeteve kemi të bëjmë me kamion.

AK nuk i ka bërë ndonjë përshkrim të qartë jo vetëm për kategorinë të automjeteve të ashtuquajtura kamioneta 3.5 ton, por nuk e ka specifikuar as kategorinë e automjeteve për largim të bores, pasi që në rastet e tilla duhet përcaktuar kapacitetin dhe duhet specifikuar se çka duhet të përmbajnë ato automjete si të tilla, por sido që të jetë kjo ka të bëjë me fazën tenderuese, e jo me fazën vlerësuese.

AK gjatë zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar nenin 7, që ka të bëjë me favorizim/mos diskriminim, nenin 59, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave, nenin 69, kapaciteti teknik dhe profesional, si dhe nenin 72 të LPP-së.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues, vlerëson se pretendimet ankimore të OE ankues "Toifor"-Prishtinë, janë të bazuara, andaj kërkon që lënda për Lot 3 të kthehet në ri-vlerësim, ndërsa pretendimet ankimore të OE "VZ Company"-Prishtinë, dhe "Ve-mor"-Pejë, i konsideron pjesërisht të bazuara dhe me këtë rast i rekomandon Panelit Shqyrtues dhe Autoritetit kontraktues që për Lotet 2 dhe 6, që të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës, me datë: 08.03.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatoret Ekonomik "Ve-mor"-Pejë, me datë: 08.03.2019, me anë të parashtresës, kanë njoftuar OSHP-në, se pajtohen pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatoret Ekonomik "VZ Company"- Prishtinë, me datë: 07.03.2019, me anë të parashtresës, kanë njoftuar OSHP-në, se pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatoret Ekonomik "Toifor"-Prishtinë, me datë: 06.03.2019, me anë të parashtresës, kanë njoftuar OSHP-në, se pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës:18.03.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi,përfaqësuesit e OE-ve ankuese, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues,përfaqësuesi i OE-së, të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimit për dhënie të kontratës, ankesat e operatoreve ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtrësit e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së“Toifor”-Prishtinëz. Mahmutajdeklaroi: Ashtu siç kemi pretenduar me ankesën në organin e prokurimit vlerësohemi me mendimin e ekspertit për këtë lende. As më tepër kemi prurë dëshmi që janë edhe në dosje është kërkuar pajisja 3.5 ton, i kemi arsyetuar pretendimet tonë por në DT është kërkuar të jenë 5 Kamion mbi 3.5 ton, në kemi prezantuar 7 Kamion kemi pretenduar dhe pretendojmë se Emërtimi Kamionet nuk ekziston në Ligj e kështu i kemi 2 kamion që shërbejnë për pastrimin e bores dhe ngarkese për mbeturina, janë në DT dhe i kam prezent 3 kamion alternativ edhe për pastrim edhe për mbeturina.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së “Ve-Mor”- Pejë,z.Asllani deklaroi: Ju informojmë se pajtohem pjesërisht me mendimin e ekspertit se arsyeja e parë e eliminimit nuk qëndronndërsa nuk pajtohem me arsyen e dytë të eliminimit për arsye se autoriteti kontraktues KK-Prishtinë, nuk na ka paralajmëruarpërvizitën në teren për të përgatitur makineritë dhe jemi zënë në befasi sepse disa makineri nuk i kemi pasur në depo në momentin e vizitës dhe ne qoftë se AK do të na informonte me kohë lidhur me vizitën në teren të gjitha makineritë do të ishin në pllato tonë dhe do të iu dëshmonim gjendjen e tyre.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së “Ve-Mor”- Pejë,z.Asllani deklaroi: Kërkoj që lënda të kthehet në rivlerësim për lot 6.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së “VZ Company”-Prishtinë , z.Tahiri deklaroi:Ne kemi kthyer një përgjigje me shkrim ku pajtohem me mendimin e ekspertit shqyrtues dhe jemi pjesërisht i bazuar ku mendojmë që është bërë shkelje në neni 69. Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së “Vz-Company” – Prishtinë, z.Tahiri deklaroi: Pajtohem me mendimin e ekspertit për lot 2.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së, znj.Isufi deklaroi:Pas kërkesës së OE-së, “Dardani” Ak e ka kthyer në rivlerësim për të gjitha lotet me qëllim për të gjetur kombinimin më të lirë të mundshëm, duke u bazuar në faktin që kështu si kriter çmimi më i ulët qëllim i kësaj vendimi është se nuk ka asnjë dispozitë ligjore që përcakton në rast të tilla veprim ky i bazuar në ligjin e prokurimit në parimin e ekonomizimit , ndërsapër mendimin e ekspertit që nuk është respektuar në neni 7 do të thotë ato mendime janë të pabazuara për

faktin se për te gjithë dëshmitë e pajisjeve që kanë qenë të paqarta edhe të pakonkretizuara me dëshmi adekuate ju është kërkuar sqarim shtese dhe kur ato nuk kanë qenë të mjaftueshme atëherë komisioni i rivlerësimit ka vendosur të dalë në teren të verifikojë ato pajisjet, ndërsa sa i përket pajisjeve të OE-së, "TOIFOR" në dëshmitë e tyre nuk ka pasur paqartësi por nuk i kanë plotësuar kërkesat e aneksit 7 të DT sepse dëshmitë e ofruara për bajonetat nuk e plotëson peshën e kërkuar, ndërsapër 7 kamionët që i ka cekur eksperti shqyrtues dhe i trajton si të njëjta me tenderuesit e tjerë ato automjete janë kamion për largimin e bores të cilat mund të shihen në librezat e qarkullimit dëshmi i dorëzohet kryetarit të panelit poashtu eksperti duke munduar ta arsyetojë ankesën e "Toifor" ka dhënë mendime të pabazuara për pajisjet të OE "NITIT" me reg. 01-599-LK të cilin e trajton për pajisjet për hedhjen e kripës pa e verifikuar librezën e qarkullimit ku shkruan se është kamion për bartjen e mbeturinave i dorëzohet dëshmi panelit shqyrtues, poashtu për pajisjet e OE DARDANIA me targa nr: 01-187-DD, 01-485-JE, 01-817-IH të cilat tenton të barazojë me pajisjet e OE ankues të cilat kemi dalë të vizitojmë në teren si dhe fotot e të njëjta që janë dërguar nga OE "Dardania" në formë elektronike ku shihet qartë se janë Automjete të destinuara për transport të mallrave ose të mbeturinave që e plotëson kërkesat e AK- se në aneksin 7. Ndërsapër OE "VEMOR" eksperti ka thënë se nuk ka të drejtë të eliminojë OE për lidhjen e një kontrate dhe mos përdorimin e pajisjeve të njëjta që kjo mund të jetë e pranueshme për ne arsyeja ka qenë që OE i njëjti nuk ka mundësi në të njëjtën kohë të kryej shërbimet me pajisje të njëjta në 2 lokacione. Në vizitën në teren është konstatuar se gjendja e makinerisë së tij është jo funksionale nuk është gjetur asnjë freze si dhe janë gjetur 2 cisterna të vjetra të paregjistruara dhe jo funksionale. Për arsyetimin që thanë është dashtë të na lajmërojnë me herët edhe vet eksperti ka cekur që është e drejtë e AK të vizitojë OE të kur ka dyshime rreth pajisjeve të tyre dhe për OE "VZ Company" eksperti ka konstatuar se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi për kamionet dhe se shqetësimet e paraqitura në ankese është dashur të shfaqë gjatë fazës së tenderimit që për ne është konstatim i pranueshëm por i njëjti i bie në kundërshtim me përgjigjet e dhëna në ankesën e OE "TOIFOR". Nga eksperti shqyrtues kërkoj ta di me tepër përllotin 3 ka propozuar të bëhet rivlerësim ndërsa loti 2 dhe 6 të mbetet në fuqi por për ne nuk është e qartë a ka të bëjë me propozimet për dhënie të kontratës nga vlerësimi i par apo nga rivlerësimi si dhe nuk është përmendur mendimi i tij rreth lotit 1,4 dhe 5.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së të rekomanduar për kontratë "ElBau" SH.P.K z. Pireva deklaroj: kompania elbau është shpallur fitues për lot 2 dhe lidhur me lot 2 OE "Toifor" ka paraqitur ankese por në lot 2 kompania "Toifor" ka ofertuar me 2 paramasaçka është në kundërshtim me ligjin që i bie se edhe nëse kthehet në rivlerësim nuk mund të shpërblehet me këtë loto ndërsa sa i përket OE-së, "VZ Company" që ka bërë ankesë për lot 2-shin qëndron arsyeja e AK-se, se është i papërgjegjshëm me arsye se nuk e ka ofruar pajisjet e kërkuar në nenin 9.1 dhe 9.2 pika 6 poashtu edhe pikën 2 janë kërkuar 4 freza dhe OE "VzCompani" ka ofruar vetëm 3 ndërsa në lidhje me pikën 7 për kamionet se nuk i ka pasur të qartë ky

OE nuk e ka shfrytëzuar të drejtën që të kërkojë sqarime sipas DT deri më 11.09.2018, por as nuk ka shfrytëzuar nenin 108 piken 3.1 që i bie se i ka pasur të qarta të gjitha dhe kërkojë që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së, për Lot 2 dhe poashtu pajtohem me mendimin e ekspertit

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues. Sheqiri deklaroj: Që lidhen me zyrtaren e AK-se pra është pak e çuditshme që një komision i vlerësimitnjë here një vlerësim e jep krejtësisht të papërgjegjshëm për të gjitha llojet për OE "Dardania", pas parashtrimit për lot 1,2,4 dhe 6 anulohen edhe lotot të cilat nuk kanë pas pretendime ankimore Zyrtarja u mundu të arsyetojë një vendim të tillë duke u thirrur në parimin ekonomikitetitpor nëse i bëjmënjëanalizëçmimeve të OE-së, të cilëtjanë rekomanduar për kontrate dhe të cilëve ju ka kërkuar dëshmitë i ka zotuar mjetet çmimet ofertuese për 4 lotot, e rekomanduara në total kanë qenë në 714.445€, pas rivlerësimit totali i këtyreloteve ka arritur 915.212 €, që do tëthotënjë ndryshim pa lot 3 dhe 6 nëse ky është parim i ekonomikacitetitpër mua ështëok. Kur kanë anuluar aktivitetin AK, nuk i njofton OE tjerëpër pezullimin e aktivitetit të prokurimit. Në pretendim ankimore nga OE "Toifor" jo për pajisjet që deklaroi tani por për pajisjet me nr të regjistrimit 01-395-IH e cila në përshkrim thotë që ështëkamionetpër bartjen e mbeturinave por në realitet ështëshpërndarëse e kripësunë nuk kam pohuar as mohuar se çfarë pajisje janë edhe në ekspertizë e kam potencuar se kërkesat nuk kanë qenë qarta se që është kamioni dhe që nënkupton me automjet me largimin e bores, kjo ka qenëçështje që është dashur të shfaqet fillimisht. Vet Anëtarja e komisionit fillimisht i trajton të përgjegjshëm por tani rezultojnë të jenë të papërgjegjshëmështë e drejt e AK-së, dhe obligim se para të marrin një vendim të shpërblim të kontratës rezultatet e vlerësimit e është jo shumë parimore pas rivlerësimit ti përmbys të gjitha ato rezultate, lidhem me OE "Toifor"janëkërkuarpër lot 3 janë kërkuar 5 kamion, ndërsa ka ofruar 7 kamion, dhe termi kamionët nuk i përgjigjet peshës 3.5 ton tëcilëtjanë të destinuar për pastrim dhe mirëmbajtje të rrugëve, në pretendimet e OE "Vemor" me anulimin e arsyetimit që ka kontrata me pajisje të njëjta. Nuk e shohë të drejt që të merret për bazë që ka një kontratë tjetër paraprake.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së "Toifor" z. Mahmutaj deklaroj: Kërkojë që ankesa jonë të aprovohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim pajtohem me raportin e Ekspertit.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Isufi deklaroj: Panelit shqyrtues, i propozojmë që mos të aprovohet mendimi i ekspertit shqyrtues por të vendos për aprovimin e rekomandimit të komisionit të rivlerësimit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues,

konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklaramit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se komisioni i vlerësimit të ofertave me datë: 14.11.2018, për dhënie të kontratës ka rekomanduar OE-të.

1. Lot 1 OE "Ve-mor" me çmim prej 179,398.05€
2. Lot 2 OE "Pastrimi" me çmim prej 126,975.14€
3. Lot 3 OE OE "Toifor" me çmim prej 409,969.38€
4. Lot 4 OE "Niti-N& Milenium Konstruktion" me çmim prej 194,391.65€
5. Lot 5 OE "Zahiri" me çmim prej 213,680.72€
6. Lot 6 OE "ElBau" me çmim prej 283,927.96€

Në mesin e tyre të rekomanduar për kontratë kanë qenë edhe operatorët ekonomik "Toifor" dhe "Ve-mor", ndërsa OE "VZ Company" nuk ka qenë i rekomanduar.

Autoriteti Kontraktues me datë: 10.12.2018, ka marrë vendim për shpërblim me kontratë për të gjitha llotet, por pas parashtrimit të Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar nga OE "Dardania" për llotet 1, 2, 4 dhe 6, Autoriteti Kontraktues, e pezullon të gjithë aktivitetin e prokurimit edhe pse në lot 3 dhe 5 nuk ka pas Kërkesë për Rishqyrtim nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës.

Pas parashtrimit të Kërkesës për Rishqyrtim AK, ka anuluar vendimin për shpërblim për të gjitha llotet, por nuk ka dhënë arsye të anulimit të lotove për të cilat nuk janë parashtruar Kërkesa për Rishqyrtim.

AK krijon komision të ri për rivlerësim, dhe pas rivlerësimit për kontratë propozon operatorët ekonomik si në vijim:

1. Lot 1 OE "Dardania" me çmim prej 261,722.50€
2. Lot 2 OE "Elbau" me çmim prej 245,418.44 €
3. Lot 3 - Anulohet
4. Lot 4 OE "Niti-N&MileniumKonstruktion" me çmim 194,391.28€
5. Lot 5 OE "Zahiri" me çmim prej 213,680.72€
6. Lot 6 - Anulohet.

Paneli shqyrtues në vazhdim jep konstatimet e tij lidhur me pretendimet ankimore të OE-së, "Toifor"-Prishtinë, ku ky OE pretendon se se nga ana e autoriteti kontraktues OE "Toifor" -Prishtinë, fillimisht

kualifikohet i përgjegjshëm dhe rekomandohet për kontratë për Llot 3, por pas Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar për llotet 1,2, 3 dhe 4 Autoriteti Kontraktues pa ndonjë arsyetim e rivlerëson edhe llotin 3, dhe në bazë të rezultateve të rivlerësimit OE “Toifor” -Prishtinë, rezulton të jetë i papërgjegjshëm. Pas Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar me datë: 30.01.2019, nga e OE “Toifor” Autoriteti Kontraktues, e refuzon kërkesën e tillë me arsyetimin se OE “Toifor”, nuk plotëson kërkesat për makineri pasi që nuk ofron kamioneta mbi 3.5 tonë.

Paneli shqyrtues konstaton se sa i përket makinerisë (pajisjeve) AK nuk ka respektuar dispozitat e nenit 7 të LPP-së, pasi që AK nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë OE ankues në raport me OE të rekomanduar sepse pjesa me e madhe e OE të cilët janë rekomanduar për kontratë ju kanë pranuar pajisjet duke i pranuar si të pranueshme edhe përmes video incizimeve, andaj me rastin e rivlerësimit autoriteti kontraktues duhet të merr parasysh nenin 7 të LPP-së dhe se vlerësimi i ofertave duhet të bëhet vetëm në bazë të atyre kritereve që janë të vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton, për llot 3 janë kërkuar 5 kamionë dhe për llotet tjera nga 4 kamion, ndërsa OE “Toifor” –Prishtinë ka ofruar 7 kamion. Andaj me rastin e rivlerësimit autoriteti kontraktues duhet të bëjë vlerësimin e ofertave në pajtim me nenin 59 të LPP-së, si dhe në pajtim me nenin 7 dhe 56.3 të LPP-së duke mos diskriminuar asnjë operator ekonomik nga konkurrenca për kërkesa të cilat nuk kanë qenë kërkesa të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se AK ka pranuar pajisje për operatorët tjerë që lidhen me kamionetat 3.5 tonë të cilat jo vetëm që nuk e kanë peshën e kërkuar por si të tilla nuk janë kamioneta por janë pajisje për shpërndarje të kripës siç është rasti për automjetet me regjistrim automjeti 01-599-1H dhe automjet me regjistrim 01-599-LK të OE “Niti-N& Milenium Konstruktion. Paneli shqyrtues konstaton se Autoriteti kontraktues në kuptim të nenit 52 dhe 59 të LPP-së, vlerësimin e ofertave nuk e ka bërë në përputhje me nenin 52 dhe 59 të LPP-së pasi që si automjete të pranueshme lidhur me kërkesën “kamioneta 3.5 ton” ka pranuar automjete që kanë peshe bartëse mbi 15 mijë apo 20 mijë ton siç është rasti me OE “Dardania” apo operatorët tjerë, andaj me rastin e rivlerësimit AK-është e obliguar që vlerësimin e ofertave ta bëjë në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë duke mos diskriminuar asnjë operator ekonomik pjesëmarrës.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se AK për të gjithë operatorët ekonomik të rekomanduar për kontratë përveç sqarimeve i ka vizituar edhe vende punishte, por një gjë të tillë nuk e ka

Faqe 12 nga 15

bërë edhe me OE "Toifor"-Prishtinë, dhe në të shumtën e rasteve ka konstatuar se pajisjet e deklarua nga Operoret Ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk gjinden në vend punishte por janë vlerësuar në bazë të video incizime, ndërsa për OE "Toifor" nuk ka ndërmarr asnjë veprim për ndonjë sqarim edhe pse paraprakisht ka qenë i përgjegjshëm dhe është rekomanduar për kontratë për llot 3 pasi që është konsideruar i përgjegjshëm dhe ka ofruar çmim me të lirë. Andaj nga te cekurat si me lart paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit AK nuk mund të diskriminoj asnjë ofertues por duhet respektuar nenin 7 të LPP-së.

Në vazhdim Paneli shqyrtues jep konstatimet e tij lidhur me pretendimet e OE "Ve-mor"-Pejë.

OE ankues "VE-mor" -Pejë, është eliminuar në mungese të plotësisht të kërkesave të nenit 91 dhe 9.2 të dosjes së tenderit konkretisht për shkak të mos posedimit të makinerisë.

Sipas Autoritetit Kontraktues arsyeja e parë e eliminimit është se OE "Ve-mor" –Pejë, paraprakisht ka lidh kontratë me Komunën e Prishtinës për mirëmbajtje dimërore të rrugëve rurale dhe njëkohësisht makineritë e tilla nuk mund ti përdor edhe në rastin konkret, dhe arsye e dytë është se gjatë vizitës në vende punishte është vërtetuar se një numër i makinerish (cisternat) janë jashtë funksionit (përdorimit) dhe si të tilla nuk mund të merren për bazë në vlerësim.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se arsyen e parë për eliminim e konsideron jo të drejtën sepse AK nuk mund të marrë për bazë një justifikim të tillë për eliminim. Nëse Komuna e Prishtinës, merr për bazë një arsye të tillë për eliminim atëherë pjesa më e madhe e OE të cilët kanë kontratë me Komunën duhet refuzuar që në fillim pasi secili prej tyre mund të ketë një kontratë paraprake, dhe të paktën një gjë e tillë edhe nëse aplikohet duhet potencuar në dosje të tenderit, sepse neni 56.3 citon: Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociatë, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Paneli shqyrtues sqaron se komisioni vlerësues sipas raporteve ka dalë në vizitë në teren dhe ka konstatuar se një numër i pajisjeve konkretisht cisternat të cilat janë prezantuar në ofertë ka konstatuar se janë jashtë funksionit, dhe nuk janë fare të regjistruara, pastaj komisioni gjatë vizitës nuk ka gjetur frezat dhe OE "Ve-mor" nuk ka arritur të dëshmojë se i posedon. Po ashtu OE ankues në mënyrë indirekte në pretendimet ankimore edhe vet e pranon se me rastin e vizitës së komisionit pajisjet nuk kanë qenë në funksion dhe frezat nuk kanë qenë në deponi pasi që kanë qenë të dhëna me qira dhe në pretendime ankimore OE "Ve-mor" e ngrit një shqetësim lidhur me mos njoftimin e me hershem për një vizitë në vend punishte. Andaj Paneli shqyrtues konsideron se me rastin e rivlerësimit AK-duhet të bëjë vlerësimin e ofertave në bazë të

kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe mos të bëjë ndonjë diskriminim apo favorizim për asnjërin nga ofertuesit pjesëmarrës.

Në vazhdim Paneli shqyrtues jep konstatimet e tij lidhur me pretendimet ankimore të OE "VZ Company"- Prishtinë.

Sipas vendimit të datës: 04.02.2018 të AK-së, lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 30.01.2019, të parashtruar nga OE "VZ Company" arsyet e eliminimit janë pasi OE ankues nuk plotëson kërkesat për makineri konkretit aneksin 7 të dosjes së tenderit.

Sipas këtij aneksi janë kërkuar pajisje të quajtura kamioneta 3.5 ton, dhe si të tilla OE ankues nuk i ka ofruar.

Paneli shqyrtues sqaron se, eksperti shqyrtues ka analizuar listën e pajisjeve të OE "VZ Company" dhe me këtë rast konstaton se pajisjet me nr. regjistrimi 04-688 KR dhe 01-163-GN janë pajisje që nuk e arrijnë peshën 3.5 ton. Mirëpo duke pas parasysh faktin se kërkesa për këto lloj makinerish ka qenë jo e qartë për Operatoret Ekonomik, autoriteti kontraktues gjatë rivlerësimit duhet të respektoj nenin 7 të LPP-së dhe të bëjë vlerësimin e ofertave në pajtim me këtë nen duke mos diskriminuar apo favorizuar asnjë operator ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Lidhur me pretendimin e ankuesit lidhur me listën e pajisjeve të ofruara Paneli shqyrtues konstaton se AK me rastin e rivlerësimit duhet të vlerësojë, ekzaminojë sektin e OE në fjalë a plotëson apo jo kërkesën e AK-së për listën e pajisjeve.

Paneli shqyrtues duke pas parasysh faktin se AK nuk i ka bërë ndonjë përshkrim të qartë jo vetëm për kategorinë të automjeteve të ashtuquajtura kamioneta 3.5 ton, por nuk e ka specifikuar as kategorinë e automjeteve për largim të bores, pasi që në rastet e tilla duhet përcaktuar kapacitetin dhe duhet specifikuar se çka duhet të përmbajnë ato automjete si të tilla, konstaton se i gjetë aktiviteti i prokurimit për të gjitha LOTET duhet të kthehet në rivlerësim në mënyrë që me rastin e rivlerësimit AK të trajtoj ofertuesit në mënyrë të barabartë në pajtim me nenin 7 të LPP-së, dhe ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të bëjë në pajtim me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 7 LPP-së Barazia në Trajtim/

Jo-Diskriminimi. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –Komuna e Prishtinës
- 1x1 OE- “Toifor” -Prishtinë,
- 1x1 OE “Ve-mor”-Pejë,
- 1x1 OE “VZ Company”- Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.